




DPK/DMP
02

03-1450/13
21-05-2013



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

Nr.450-05/2012

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Divizioni për Kundërvajtje , me gjyqtarin Gjimshit Galushi , dhe procesmbajtësen Nexhla Vebiqi në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Hyrmet Veliu nga Prizreni , për shkak të kundërvajtjes nga neni 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar sipas nenit 17.par.1.1 të Ligjit për Deklarim, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik , e në bazë të nenit 195 të LMK-së , me datën 16.04.2013 merr këtë :

A K T V E N D I M

I pandehuri Hyrmet Xhevat Veliu , i lindur me 03.06.1960, në fsh.Zaplluzhë KK Prizren, kurse tani jeton në Prizren , në rrugën Naip Berisha nr. 83 , i gjendjes së mesme ekonomike , deri më tani i pa denuar.

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse , si Zyrtar i lartë publik - drejtor i arkivit historik në Prizren , nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë dhe prejardhjen e saj , pranë Agjencisë kundër Korrupsionit - brenda afatit Ligjor (deri më 31.03.2012), pasi që ka qenë i obliguar ,

- me kete veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar sipas nenit 17.par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik ,

Andaj në bazë të dispozitave të theksuar ligjore, dhe konform nenit 10 të LMK-së , shqiptohet ,

Q O R T I M

Shpenzimet e procedurës biejnë në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës .

A r s y e t i m

Sipas kërkesës së Agjencisë kundër Korupsionit të Republikës së Kosovës - në Prishtinë , me nr.01-1621/2012 të datës 30.04.2012 , u zhvillua procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Hyrmet Veliu nga Prizreni , për shkak të kundërvajtjes nga neni 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar sipas nenit 17.par.1.1 të Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik .

Gjendja faktike është vërtetuar në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës , si dhe deklaratës së të pandehurit , i cili në deklaratën e tijë ka theksuar se edhe njoftimi - formulari për deklarimin e pasurisë e ka marur me vonesë, nga vet dega e arkivit në Prishtinë , të cilën menjtëherë ka plotësuar , dhe me datën 05.04.2012 e ka dërguar formularin mbi deklarimin e pasurisë në Agjencion kundër korupsionit të Republikës së Kosovës , i cili edhe është pranuar dhe vërtetuar me datën 11.04.2012.

Nga të dhënat e parashtruar në kërkesë , vlerësimi të deklaratës së të pandehurit , si dhe vlerësimi të të gjitha provave së bashku dhe secilës veç e veç të bashkangjitura në kërkesë , Gjykata konstatoi se me datën 04.04.2012 i pandehuri me të vërtet kishte plotsuar , e me datën 05.04.2012 , edhe ka dërguar formularin mbi deklarimin e pasurisë në Agjencion kundër korupsionit , i cili ishte pranuar me datë 11.04.2012 , edhe pse pas afatit për dorzim .

Duke pasur parasysh rethanat nga neni 7 të LMK-së , se i njejt ka patur sjelljet të mira , e poashtu faktin se me vonesë është njoftuar me formularin mbi deklarimin e pasurisë nga vet dega e arkivit në Prishtinë , se nga afati ligjorë për deklarimin e pasurisë kanë kaluar **dhjetë ditë** , gjykata është qëndrimin se në veprimet e të pandehurit egzistojnë elementet e veprës së kundërvajtjes nga dispozitat e shenuara më lartë , mirpo i shqiptoi Qortim , sepse egzistojnë edhe rethanat të cilat në masë të konsiderueshme e zvoglojnë përgjegjësin e kryersit , konform nenit 10 të LMK-së , me bindje se edhe me këtë llojë të denimit do të arihet qëllimi i ndëshkimit , që i njejt në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të tilla apo të ngjajshme , dhe të respektoj afatin ligjore .

Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në bazë të nenit 7 të LMK-së, në bazë të të cilave u shqiptua dënimi i theksuar më lartë .

Vendimi mbi shpenzimet gjyqsore është marrë konform nenit 113 të LMK-së .

Me sa u cek me larte, u vendos si ne dispozitiv te aktvendimit .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Divizioni për Kundërvajtje
Nr.450-05/2012, datë: 16.04.2013

Gjyqtari
Gjimshît Galushi

UDHËZIMI JURIDIK : Kundër këtij aktvendimi, pala e pakenaqur mund të ushtrojë ankesë
Gjykatës së Apelit - Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditëve, ose më pas në afat
prej 15 ditësh nga dita e aktvendimit.